

LIGJ
Nr.9702, datë 2.4.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT KUFITARE MURIQAN-SUKOBIN NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI NË MURIQAN”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi në Muriqan”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5263, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR MURIQAN-SUKOBIN MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI NË MURIQAN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi (në vijim të referuara si Palët në këtë Marrëveshje),

duke marrë parasysh marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet vendeve;

duke marrë parasysh vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin;

duke marrë parasysh synimin për arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe europian;

me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e masave në lidhje me kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar ndërmjet vendeve;

si konfirmim i marrëveshjeve të arritura deri tani në nivelet e larta politike;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët kanë rënë dakord për të hapur dhe filluar funksionimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Muriqan-Sukobin (në vijim referuar si PPKK).

PPKK-ja do të ndërtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në vendin e quajtur Muriqan.

PPKK-ja do të fillojë të funksionojë menjëherë pas përfundimit të ndërtimit dhe të

procedurave ligjore të brendshme për të dyja vendet në lidhje me hyrjen në fuqi të protokolleve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Palët do të krijojnë një Komitet të Përbashkët të Ekspertëve (në vijim KPE), i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes.

KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila Palë që përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

Vendndodhja e saktë e PPKK-së, si dhe parametrat teknikë të saj do të përcaktohen nga KPE-ja.

Neni 3

Palët ranë dakord, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e KPE-së, të nënshkruajnë protokolle zbatimi, në të cilat do të përcaktohen çështjet teknike dhe financiare që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e PPKK-së.

Palët janë të lira të shtojnë shtojca përkatëse në këtë Marrëveshje për të parashikuar çështjet që nuk rregullohen nga ajo.

Neni 4

Mosmarrëveshjet e mundshme rreth shpjegimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja.

Në rast se brenda afatit prej 3 muajsh KPE-ja nuk do të mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja Palët në këtë Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella ndërmjet dy qeverive deri në fundin e muajit pasardhës.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën në të cilën të dyja shtetet marrin njoftimin e dytë të dërguar njëra-tjetrës për të vënë në dijeni se kanë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacionet e shteteve të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund ta denoncojë Marrëveshjen me anë të dorëzimit të një note verbale me shkrim në rrugë diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit mbi denoncimin e saj nga Pala tjetër.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Ulqin, më 17.1.2007, në tri kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze, të gjitha tekstet njëloj të besueshme. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e Marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.